

VENDIM
Nr. 201, datë 2.12.2020

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË GSA SHPK, ME NR. 321, SERIA T11/15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 8, nenit 9, nenit 13, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/1 prot., datë 27.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë GSA sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 6.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë GSA sh.p.k. nr. 321, seria T11/15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011, dhe rinovuar me vendimin nr. 160, datë 28.12.2015.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/34 prot., datë 9.11.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankese nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria GSA sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1184 prot., datë 9.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria GSA sh.p.k., me shkresën nr. 1184/1 prot., datë 17.11.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 30.6.1993, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Shoqëria GSA sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 321, seria T11/15, të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike që prej datës 22.6.2011, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, me afat vlefshmërie deri në datën 22.6.2016, të rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 28.12.2015, për pesë vjet të tjera.

- Shoqëria GSA sh.p.k. ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, si dhe ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë GSA sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, geramat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 321, seria T11/15, të shoqërisë GSA sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011, i ndryshuar, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 23.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti